



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 31 janar 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Zgjatje Afati

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup

Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenet 39(1)) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullën 9 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 tetor 2021, afati për nxjerrjen e materialit të padorëzuar sipas rregullës 102(1)(b) dhe përkthimin e këtij materiali u shty deri më datën 31 janar 2022.²
2. Më 27 janar 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) kërkoi zgjatjen e afatit për nxjerrjen e një numri të kufizuar materialesh sipas rregullës 102(1)(b) (“Kërkesa”).³ Më të njëjtën ditë Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi dorëzimin e përshpejtuar të përgjigjeve dhe kundërpërgjigjes ndaj Kërkesës.⁴
3. Më 28 janar 2022, the Mbrojtja e Jakup Krasniqit (“Mbrojtja e Krasniqit”) dhe Mbrojtja e Kadri Veselit (“Mbrojtja e Veselit”) (bashkërisht “Mbrojtja”) dorëzuan përgjigjet ndaj Kërkesës (përkatësisht, “Përgjigjja e Krasniqit” dhe “Përgjigjja e Veselit”).⁵
4. Më 31 janar 2022, ZPS-ja iu kundërpërgjigj Përgjigjes së Krasniqit dhe Përgjigjes së Veselit (“Kundërpërgjigjja”).⁶

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, Transkript i Seancës Gjyqësore, 29 tetor 2021, publik, f. 753, rreshti 21-25 deri tek f. 754, rreshti 1-3.

³ KSC-BC-2020-06, F00657, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatje Afati*, 27 janar 2022, konfidencial. Një version publik i redaktuar u protokollua më të njëjtën ditë, F00657/RED.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00659, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Ndryshim Afati*, 27 janar 2022, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00661, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Zgjatje Afati*, 28 janar 2022, publike; F00662, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Zgjatje Afati (KSC-BC-2020-06/F00657)*, 28 janar 2022, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00664, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë në Lidhje me Kërkesën për Zgjatje Afati*, 31 janar 2022, konfidencial. Një version publik i redaktuar u protokollua më të njëjtën ditë, F00664/RED.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej trupit gjykues.

III. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja kërkon zgjatjen e afatit për nxjerrjen e një numri të kufizuar materialesh sipas rregullës 102(1)(b), konkretisht disa incizime audiovizuale dhe dy prova materiale ("Materiale për Miratim nga një Palë e Tretë sipas Rregullës 102(1)(b)").⁷ ZPS-ja mendon se ekziston arsye e vlefshme për ndryshimin e kërkuar duke pasur parasysh se nxjerrja e këtyre materialeve varet nga subjekte që janë palë të treta me të cilat ZPS-ja është angazhuar në mënyrë të zellshme.⁸ ZPS-ja thekson më tej se në këto rrethana paragjykimi do të jetë minimal, nëse do të ketë.⁹

7. Mbrojtja e Krasniqit nuk e kundërshton Kërkesën në qoftë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake i cakton Prokurorisë një afat të realizueshëm për nxjerrjen e materialit në fjalë.¹⁰

8. Mbrojtja e Veselit e kundërshton Kërkesën pasi: (i) nuk u paraqit në kohë duke pasur parasysh se afati për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(b) u përcaktua tre muaj më parë;¹¹ (ii) nuk është paraqitur arsye e vlefshme duke pasur parasysh se ZPS-ja priti më shumë se katër muaj pas konfirmimit të Aktakuzës për sigurimin e vendimit për të urdhëruar marrjen e dokumentacionit të kërkuar duke shtuar vonesa të mëtejshme në procesin gjyqësor;¹² dhe (iii) masa e redaktimeve të kryera tek

⁷ Kërkesa, para. 1.

⁸ Kërkesa, para. 1-3.

⁹ Kërkesa, para. 1, 4.

¹⁰ Përgjigja e Krasniqit, para. 3-4.

¹¹ Përgjigja e Veselit, para. 2-3.

¹² Përgjigja e Veselit, para. 2, 5.

intervistat e ndërlidhura e pengon dhënien e një përgjigjeje të njëmendtë ndaj Kërkesës.¹³

9. Në Kundërpërgjigjen e vet, ZPS-ja thekson se ka paraqitur arsye të vlefshme për zgjatjen e kërkuar të afatit dhe ka ushtruar zellin e arsyeshëm në rrethanat ekzistuese.¹⁴ Sa i takon afatit për zgjatje, ZPS-ja sugjeron se ky afat mund të rishqyrtohet gjatë një konference mbi ecurinë e çështjes në mars 2022.¹⁵

IV. DISKUTIM

10. Për sa u takon incizimeve audiovizuale dhe dy provave materiale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se dhënia e këtij materiali varet nga subjekte që janë palë të treta. ZPS-ja ka ndërmarrë konsultimet e nevojshme dhe ka paraqitur kërkesë për dhënien e këtij materiali.¹⁶ Për këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se [REDAKTUAR] duhur [REDAKTUAR] për materialin audiovizual tashmë janë nxjerrë, por vetëm së fundi u bë e njohur se dhënia e këtyre materialeve po cenohet [REDAKTUAR].¹⁷ Në lidhje me provat materiale të ndërlidhura, ZPS-ja ka nisur kërkesat për verifikimin e sigurisë, por ende nuk i ka marrë këto verifikime sigurie.¹⁸ Në këto rrethana, nuk ka asnjë tregues se ZPS-ja nuk ka vepruar në mënyrë të zellshme. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është demonstruar arsyeja e vlefshme e cila përlligj zgjatjen e afatit.

11. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se zgjatja e kërkuar e afatit ka të bëjë me një sasi minimale materiali sipas rregullës 102(1)(b) dhe [REDAKTUAR] dhe intervistat e ndërlidhura me materialin në fjalë tashmë janë nxjerrë.¹⁹ Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se zgjatja e

¹³ Përgjigja e Veselit, para. 2, 7.

¹⁴ Kundërpërgjigja, para. 2-3.

¹⁵ Kundërpërgjigja, para. 4.

¹⁶ Kërkesa, para. 2-3.

¹⁷ Kërkesa, para. 2.

¹⁸ Kërkesa, para. 3.

¹⁹ Kërkesa, para. 4.

afatit për të nxjerrë Materialet për Miratim nga një Palë e Tretë sipas Rregullës 102(1)(b) do të ketë pasoja të kufizuara në ecurinë e procesit gjyqësor, sidomos sepse procesi i nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102(3) ende vazhdon. Megjithatë, për të siguruar ecurinë e shpejtë të procesit gjyqësor Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se duhet përcaktuar një afat për nxjerrjen e këtij materiali dhe nuk duhet miratuar zgjatje e pakufizuar e afatit. Rrjedhimisht, ZPS-ja duhet të vijojë në mënyrë të zellshme konsultimet e saj me subjektet përkatëse që janë palë të treta për realizimin e nxjerrjes së materialit audiovizual dhe të dy provave materiale të ndërlidhura brenda ditës së enjte, 31 mars 2022.

12. Së fundi, sa u takon redaktimeve të kryera tek intervistat e ndërlidhura Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se përmbajtja e këtyre intervistave do të ketë ndikim të pakët ose nuk do të ketë asnjë ndikim në aspektin nëse përlijet zgjatja e afatit për nxjerrjen e dy provave materiale të ndërlidhura që kërkojnë verifikimin e sigurisë nga subjekte që janë palë të treta. Lidhur me pikën procedurale në shqyrtim, konkretisht nëse është treguar se ekziston arsye e vlefshme për zgjatjen e kërkuar të afatit, Mbrojtja është përgjigjur mjaftueshëm.

V. VENDIM

13. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** Kërkesën; dhe
- b. **URDHËRONS** ZPS-në që brenda ditës së **enjte, datë 31 mars 2022**, të nxjerrë Materialet për Miratim nga një Palë e Tretë sipas Rregullës 102(1)(b).

 /nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 31 janar 2022

Në Hagë, Holandë.